



## FAKULTETI I KOMUNIKIMIT MASIV

Studimet master

Punim masteri:

# POPULIZMI NË FJALIMET E ALBIN KURTIT GJATË FUSHATAVE ELEKTORALE 2019-2021

Kandidatja

Ardiana Thaçi-Mehmeti

Mentori

Prof. Ass. Dr. Hasan Saliu

Prishtinë, 2022

## **Deklaratë**

Deklaroj që këtë temë master e kam punuar në mënyrë të pavarur, pa asnjë ndikim dhe kopjim, të gjitha burimet janë marrë nga mediat vizive në Kosovë gjatë vitit 2019-2020 dhe burime tjera mbështetëse teorike të autorëve të ndryshëm botërorë.

Deklaroj se, përveç mentorit tim, që ishte në mbështetjen time gjatë gjithë kohës, askush tjetër nuk është i njoftuar me punimin dhe ky punim është autentik dhe i papublikuar deri më sot.

Burimet e tjera të përdorura që gjinden në punim janë të cituara dhe referuara.

Ardiana Thaçi-Mehmeti

---

Datë:     /     /2022

## **Falënderim!**

“A e kreve temën, ende je vetëm me fakultet?” Ndoshta është e pazakontë ta nis falënderimin me një fjali të tillë, por kjo ka qenë pyetja që e kam dëgjuar çdo mëngjes prej momentit kur kam përfunduar provimet në master. Andaj ky punim i dedikohet njeriut që ishte shtytës dhe modeli që unë kam ndjekur gjithë këto vite, babait tim Tahirit.

Falënderoj fëmijët e mi Diarin, Andin dhe Rrapin e vogël, që më mirëkuptuan gjithë këto kohë, kur ndoshta nuk isha sa duhet e pranishme në përditshmërinë e tyre, qoftë gjatë kohës së ligjëratave apo netëve të gjata kur ua mbaja dritën ndezur teksa kërkoja në internet materiale për të përmbyllur një synim timin, por i cili shpresoj që në të ardhmen do të jetë model i tyre.

Bashkëshortin tim Butrintin, që gjatë kohës së mësimin online, ishte i detyruar të ngujohet me orë të tëra në dhomë bashkë me fëmijët, për të më ofruar qetësinë e nevojshme për të ndjekur mësimin.

Falënderim i veçantë për mentorin tim, prof. Hasan Saliu, i cili nuk u kursye asnjëherë për të kontribuar në realizimin e këtij studimi, duke më mbështetur dhe ndihmuar si me konceptimin e saj, por edhe me gjetjen e literaturës adekuate.

Dhe gjithashtu një falënderim për të gjithë profesorët e Kolegjit AAB, drejtimit të Komunikimit Masiv dhe Gazetari, që besuan në mua dhe më motivuan të jem sot këtu.

Dhe në fund, por jo nga rëndësia, falënderoj nënën time Hanifen për faktin që më mësoi që gjërat arrihen me qetësi e punë, por që për të pasur sukses, bashkë me to duhet patjetër të shtosh një dozë të madhe të dashurisë.

## **Abstrakti**

Populizmi po shënon rritje në gjithë Evropën, për shkak të keqeverisjeve, krizës financiare globale dhe paqëndrueshmërisë së partive politike. Brexit ishte njëri nga proceset që u iniciua nga populistët, duke i sulmuar pikërisht këto veprime. Qëllimi i punimit ka qenë studim i retorikës populiste që Albin Kurti, tani kryeministër i Kosovës, përdori në tri fushata zgjedhore, që i dhanë partisë së tij rritjen më të madhe popullore në historinë e politikës kosovare. Janë nxjerrë në pah rrethanat që ia mundësuan Kurtit që populizmi i tij të pranohet nga elektorati. Nga analiza e diskursit të tij elektoral rezulton se qëllimi i madh i Kurtit u ndihmua gjithashtu nga paqëndrueshmëria politike, pakënaqësia e qytetarëve nga pushtetet e mëparshme dhe fakti që mandati i tij i parë u shkurtua në mes të emergjencës shëndetësore globale.

Fjalët kyçe: **Populizmi, retorika populiste, Albin Kurti, nacionalizmi, populizmi i djathtë, populizmi i majtë.**

## **Abstract**

Populism has seen a rapid grow all around Europe, due to bad governing, global economic crisis and instability of political parties. BREXIT was one those processes which was initiated by populists, attacking those shortcomings. This study is based on the populist rhetoric from now PM of Kosovo, Albin Kurti, the one he used in the last three election campaign for general elections, which resulted in him eventually recording the highest ever win in Kosovo's political history. This study piece revolves around circumstances which enabled Kurti's populism to be embraced by Kosovo voters. Kurti's big goal was also helped by political instability, citizens discontent from previous regimes, and his first mandate cut short in midst of global health emergency.

Key words: **Populism, populist rhetoric, Albin Kurti, nationalism, right wing populism, left wing populism'**

## Tabela e Përmbajtjes

|   |                              |
|---|------------------------------|
| Deklaratë .....                                   | 2                            |
| Falënderim! .....                                 | 3                            |
| Abstrakti.....                                    | 4                            |
| Qëllimi i këtij punimi të masterit .....          | 8                            |
| Objektivat.....                                   | 8                            |
| Pyetjet që shtrohen .....                         | 8                            |
| Hipotezat.....                                    | 9                            |
| Rëndësia e hulumtimit: .....                      | Error! Bookmark not defined. |
| Metodologjia:.....                                | 9                            |
| Kapitulli I .....                                 | Error! Bookmark not defined. |
| 1. Kuptimi i populizmit?.....                     | Error! Bookmark not defined. |
| KAPITULLI II .....                                | Error! Bookmark not defined. |
| 2. Ndarjet e populizmit.....                      | Error! Bookmark not defined. |
| 2.1 Populizmi i djathtë.....                      | Error! Bookmark not defined. |
| 2.2 Populizmi i majtë.....                        | Error! Bookmark not defined. |
| 2. 3 Populizmi dhe nacionalizmi.....              | Error! Bookmark not defined. |
| KAPITULLI III.....                                | Error! Bookmark not defined. |
| 3. Diskursi politik i Albin Kurtit.....           | Error! Bookmark not defined. |
| 3.1 Karriera e hershme e Kurtit.....              | Error! Bookmark not defined. |
| 3.2 Fushata për zgjedhjet parlamentare 2019 ..... | Error! Bookmark not defined. |
| 3.3 Fushata për zgjedhjet parlamentare 2021 ..... | Error! Bookmark not defined. |
| 3.4 Fushata për zgjedhjet lokale 2021 .....       | Error! Bookmark not defined. |
| Kapitulli IV.....                                 | Error! Bookmark not defined. |
| 4. Diskutime dhe Interpretime .....               | Error! Bookmark not defined. |
| 4.1 Diskutime .....                               | Error! Bookmark not defined. |
| 4.2. Interpretimi .....                           | Error! Bookmark not defined. |
| 4.3 Përfundimi .....                              | Error! Bookmark not defined. |
| 4.4. Rekomandimi.....                             | Error! Bookmark not defined. |
| Bibliografia .....                                | 67                           |
| Webliografia .....                                |                              |

## Hyrje

Populizmi është bërë një gjë e zakonshme, është duke u rritur në çdo vend dhe, sipas studimeve, kjo vjen si kundërpërgjigje e politikave liberaliste, sulm ndaj elitave politike dhe ekonomike në përgjithësi (përfshirë edhe elitat e medias) dhe pabarazive në rritje dhe ndjenjës së të qenit i shkëputur nga vendimmarrja qeveritare.

Studiuesi Jan-Werner Muller ka precizuar që populizmi është një mënyrë qartësisht morale për të imagjinuar botën politike dhe domosdoshmërisht nënkupton një pretendim për përfaqësim ekskluzivisht moral.<sup>1</sup> Ky fakt me të drejtë mund të ngrehë dilemën nëse Albin Kurti, në zgjedhjet parlamentare të viteve 2019 dhe 2021, përdori populizmin për të arritur mobilizimin e masave.

*“Korrupsioni dhe krimi e kanë lënë Kosovën si shtet të dobët, në të cilin ka individë më të fuqishëm se shteti. Në qeverinë tonë të re, nuk do të ketë asnjë individ të fuqishëm, para të cilit do të zbrapsemi ne dhe nuk do të ketë asnjë kriminel që nuk do të zbrapset, gjykohet e dënohet nga drejtësia e shtetit dhe fuqia e ligjit... Shteti nuk mund të durojë të korruptuarit... Hajnat në burg”.*<sup>2</sup> Në këtë fjalim, Albin Kurti sulmon në mënyrë të drejtpërdrejtë elitën politike, ekonomike e të drejtësisë, gjë që ngre hipotezat që kërkojnë studime për të analizuar nëse fjalimet e tij gjatë fushatave zgjedhore 2019 - 2021 përmbajnë retorikë populiste.

Gjatë shqyrtimit të literaturës vërehen ngjashmëri të fjalimeve të Kurtit me ato të liderëve populistë në Evropë dhe Amerikë, të cilët i përkasin populizmit të majtë apo atij të djathtë. Kjo ngjashmëri vërtetohet nëse bëhet krahasimi mes manifestit të Kurtit më 12 shkurt të 2021-ës, kur gjatë fushatës në Prishtinë deklaroi: “14 shkurtin le ta kujtojnë gjeneratat që do të vijnë pas nesh, si ditën kur populli u bë bashkë si kurrë më parë (...) sepse ne meritojmë një Kosovë më të mirë që kujdeset për të varfrit dhe i mbron të dobët.”<sup>3</sup> Retorikë të ngjashme, që studiuesit e kanë kategorizuar si populiste, kishte përdorur edhe Donald Trump, në fjalimin e inaugurimit të tij më

---

<sup>1</sup> Jan Warner Muller, in *What Is Populism?*, trans. Enela Topulli (Prishtinë, Kosovë: Botimet Poema, 2019), p. 55.

<sup>2</sup> Albin Kurti, Mitrovicë

<sup>3</sup> Kurti, Prishtinë, 12 shkurt

20 janar 2017, kur kishte deklaruar se: “Populli po udhëheq serish, pas përbuzjes së një establishmenti të huaj dhe të urreyer që kishte zaptuar Uashingtonin.”<sup>4</sup>

Studiuesit janë të ndarë në dy taborë sa i përket retorikës populiste. Njëri krah këtë retorikë e karakterizon si kërcënim për demokracinë liberaliste, ndërsa krahu tjetër e shohin atë si korrigjim të mundshëm i një politike që është bërë në njëfarë mënyre shumë e largët nga populli.

Ky studim ka në fokus edhe faktet që dëshmojnë se populizmi është më tepër një ideologji e të folurit sesa e të vepruarit.

Jan Muller thekson se përkundër dijes së përgjithshme, populistët mund të qeverisin mbi bazën e pretendimit të tyre për përfaqësim ekskluzivisht moral të popullit. Studimet e tij mbi populizmin vijnë në përfundim se nëse populistët kanë mjaftueshëm pushtet, do të përfundojnë duke krijuar një shtet autoritarist, që përjashton të gjithë ata që nuk konsiderohen si pjesa "e duhur" e popullit.

Studimet mbi populizmin në Evropë dhe Amerikë nxjerrin në pah retorikën populiste të presidentit të 45-të të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Trump, ish-kryeministrit italian, Silvio Berlusconi, ish-kandidates për presidente të Francës, Marine Le Pen, ish-presidentit të Venezuelës, Hugo Chavez. Por çfarë është saktësisht populizmi? Kush është "populli" dhe kush mund të flasë në emër të tij? Këto pyetje nuk kanë qenë ndonjëherë kaq intriguese për t'i zbërthyer në kohërat e tanishme.

Andaj, ky studim analizon dhe krahason retorikën populiste të kryeministrit të tanishëm të Kosovës, Albin Kurtit, që i përdori në tri fushata zgjedhore gjatë periudhës 2019-2021.

Pashmangshëm në këtë studim do të përfshihet edhe fjalimet e Kurtit pas zgjedhjes së tij si kryeministër, pasi që këtë mandat ai e fitoi brenda kohës e cila është objekt i studimit.

Ky studim do të japë përgjigje pyetjes se a ishin sulmet e Kurtit kundër paraardhësve të tij në pushtet që ndikuan në fitoren e tij.

---

<sup>4</sup> [https://www.youtube.com/watch?v=pHtNOoN5rhk&fbclid=IwAR0MWTcMxnFVhWIG-abYOqEC9rQJ8urQ1TsfB7b\\_64DI007RmCqDaCyYq\\_4](https://www.youtube.com/watch?v=pHtNOoN5rhk&fbclid=IwAR0MWTcMxnFVhWIG-abYOqEC9rQJ8urQ1TsfB7b_64DI007RmCqDaCyYq_4)

## **Qëllimi i këtij punimi të masterit**

Ky punim kishte për qëllim të identifikojë dhe analizojë deklaratat e Albin Kurtit gjatë fushatave për zgjedhje parlamentare në vitet 2019 dhe 2021 dhe të krahasojë nëse këto deklarata janë në frymën e populizmit.

## **Objektivat**

Objektivat e këtij punimi kanë qenë:

Të identifikohen deklaratat e Albin Kurtit në fushatën e zgjedhjeve të përkohshme parlamentare të Kosovës nga 25 shtatori deri më 4 tetor dhe ato të zgjedhjeve parlamentare në vitin 2021, nga 3 shkurti deri më 14 shkurt, të transmetuara në mediat vizive.

Objektiv tjetër ishte analizimi i deklaratave të Albin Kurtit nëse për nga përmbajtja prekin çështjet kryesore të populizmit: sulmi ndaj oponentëve politikë, pretendimi për çmontimin e elitës politike, paraqitja e subjektit të tij si shpëtimtar të vendit, se vetëm ata janë të mirët e të pakorruptuarit etj.

Të analizohen nëse përmbajtja e fjalimeve të Kurtit ka në strukturën e tij nacionalizëm, të cilin e kishte trumbetuar më parë.

Të krahasohen deklarimet e tij me ato të liderëve që janë të njohur si populistë, si Donald Trump, Silvio Berlusconi, Marine Le Pen, Viktor Orbán

## **Pyetjet që shtrohen**

Pyetjet, të cilave u është dhënë përgjigje në këtë punim, janë.

- Si i unifikoi Kurti objektivat e tij elektorale me atë që donte populli?
- Si i shfrytëzoi pakënaqësitë e popullit në kohë pandemie për të arritur të fitorja?
- Në çfarë forme i sulmonte kundërshtarët politikë Albin Kurti dhe cilat ishin epitetet më të shpeshta që i bënte kundrejt elitës politike?
- A është populizmi i Albin Kurtit nacionalizëm?



- Sa ngjasojnë fjalimet e tij me ato të liderëve botërorë që janë të njohur si populistë?

## **Hipotezat**

**Hipoteza 1:** Albin Kurti, gjatë fushatave elektorale të viteve 2019 dhe 2021, ka përdorur metoda populiste;

**Hipoteza 2:** Kurti shfrytëzoi zhgënjimin e popullit kundrejt politikave të qeverive të kaluara për të ardhur në pushtet.

## **Metodologjia:**

Ky punim mbi populizmin e Albin Kurtit është studim i llojit cilësor, sepse mbështetet në qasjet dhe metodat cilësore në grumbullimin, përpunimin dhe analizën e të dhënave. Duke qenë se ky punim synon të bëjë analizën e përmbajtjes së deklarimeve të Albin Kurtit në fushatat elektorale në vitet 2019 dhe 2021 dhe ndikimin që ka pasur metoda populiste në ndërtimin e kësaj ngritjeje, metodat kualitative janë metoda adekuate që mundësojnë thellimin dhe shqyrtimin e aspekteve të tilla terminologjike.

Në këtë punim fillimisht është përdorur metoda e kërkimit bibliografik, ku janë shpjeguar konceptet e populizmit dhe format e ndërtimit politik. Ndërsa është shfrytëzuar edhe metoda e krahasimit, për të parë “shabllonet” e përvetësuar nga liderë të ndryshëm demokratë dhe autokratë, për të ndërtuar karizmin e tyre politik.

## Bibliografia

- Abrashi, Gazmend, Sallauka, Urim. Use of Information Technology in Academic Library Practice. *The International Information & Library Review*, (2022), 54(4), 380–386. <https://doi.org/10.1080/10572317.2022.2124834>
- Akkerman, Tjitske. “Populism and Democracy: Challenge or Pathology?” *Acta Politica* 38, no. 2 (2003): 147–59. <https://doi.org/10.1057/palgrave.ap.5500021>
- “Benedict, Anderson. *Imagined Communities: Reflections on the Origin and Spread of Nationalism*. London: Verso; Distributed by Schocken, New York. 1983. Pp. 160.” *The American Historical Review*, 1985. <https://doi.org/10.1086/ahr/90.4.903>
- Bonansinga, Donatella. “‘a Threat to Us’: The Interplay of Insecurity and Enmity Narratives in Left-Wing Populism.” *The British Journal of Politics and International Relations* 24, no. 3 (2022): 511–25. <https://doi.org/10.1177/13691481221078187>
- Bos, Linda, Lisanne Wichgers, and Joost van Spanje. “Are Populists Politically Intolerant? Citizens’ Populist Attitudes and Tolerance of Various Political Antagonists.” *Political Studies*, 2021, 003232172110492. <https://doi.org/10.1177/00323217211049299>
- Canovan, Margaret. “Trust the People! Populism and the Two Faces of Democracy.” *Political Studies* 47, no. 1 (1999): 2–16. <https://doi.org/10.1111/1467-9248.00184>
- Chernobrov, Dmitry. “Who Is the Modern ‘Traitor’? ‘Fifth Column’ Accusations in US and UK Politics and Media.” *Politics* 39, no. 3 (2018): 347–62. <https://doi.org/10.1177/0263395718776215>
- Chiocchetti, Paolo. “‘Make Way for the People!’ Left-Wing Populism in the Rhetoric of Jean-Luc Mélenchon’s 2012 and 2017 Presidential Campaigns.” *Left Radicalism and Populism in Europe*, 2019, 106–28. <https://doi.org/10.4324/9781351133630-6>.
- De Cleen, Benjamin, and Yannis Stavrakakis. “Distinctions and Articulations: A Discourse Theoretical Framework for the Study of Populism and Nationalism.” *Javnost - The Public* 24, no. 4 (2017): 301–19. <https://doi.org/10.1080/13183222.2017.1330083>

- De Cleen, Benjamin, and Yannis Stavrakakis. "Populismo y Nacionalismo: Representando Al Pueblo Como 'Los De Abajo' y Como Nación." *Anales de la Cátedra Francisco Suárez* 53 (2018). <https://doi.org/10.30827/acfs.v53i0.7427>
- De Cleen, Benjamin. "Chapter 1. the Populist Political Logic and the Analysis of the Discursive Construction of 'the People' and 'the Elite.'" *Imagining the Peoples of Europe*, 2019, 19–42. <https://doi.org/10.1075/dapsac.83.02cle>
- De Cleen, Benjamin. "Populism and Nationalism." *Oxford Handbooks Online*, 2017. <https://doi.org/10.1093/oxfordhb/9780198803560.013.18>
- Donà, Alessia. "Radical Right Populism and the Backlash against Gender Equality: The Case of the Lega (Nord)." *Contemporary Italian Politics* 13, no. 3 (2021): 296–313. <https://doi.org/10.1080/23248823.2021.1947629>
- Freden, Michael. "Is Nationalism a Distinct Ideology?" *Political Studies* 46, no. 4 (1998): 748–65. <https://doi.org/10.1111/1467-9248.00165>
- Gagnon, Jean-Paul, Emily Beausoleil, Kyong-Min Son, Cleve Arguelles, Pierrick Chalaye, and Callum N. Johnston. "What Is Populism? Who Is the Populist?" *Democratic Theory* 5, no. 2 (2018): vi–xxvi. <https://doi.org/10.3167/dt.2018.050201>
- Heinisch, Reinhard, Emanuele Massetti, and Oscar Mazzoleni. "Populism and Ethno-Territorial Politics in European Multi-Level Systems." *Comparative European Politics* 16, no. 6 (2018): 923–36. <https://doi.org/10.1057/s41295-018-0142-1>
- JAGERS, JAN, and STEFAAN WALGRAVE. "Populism as Political Communication Style: An Empirical Study of Political Parties' Discourse in Belgium." *European Journal of Political Research* 46, no. 3 (2007): 319–45. <https://doi.org/10.1111/j.1475-6765.2006.00690.x>
- Jansen, Robert S. "Populist Mobilization: A New Theoretical Approach to Populism." *Sociological Theory* 29, no. 2 (2011): 75–96. <https://doi.org/10.1111/j.1467-9558.2011.01388.x>

- Ketola, Markus, and Johan Nordensvard. "Reviewing the Relationship between Social Policy and the Contemporary Populist Radical Right: Welfare Chauvinism, Welfare Nation State and Social Citizenship." *Journal of International and Comparative Social Policy* 34, no. 3 (2018): 172–87. <https://doi.org/10.1080/21699763.2018.1521863>
- "Language and Identity: The Politics of Nationalism." *The Politics of Fear: What Right-Wing Populist Discourses Mean*, 2015, 70–96. <https://doi.org/10.4135/9781446270073.n4>
- Marcos-Marne, Hugo. "A Tale of Populism? the Determinants of Voting for Left-Wing Populist Parties in Spain." *Political Studies* 69, no. 4 (2020): 1053–71. <https://doi.org/10.1177/0032321720950215>
- Mouzelis, Nicos. "On the Concept of Populism: Populist and Clientelist Modes of Incorporation in Semiperipheral Polities." *Politics & Society* 14, no. 3 (1985): 329–48. <https://doi.org/10.1177/003232928501400303>
- Mudde, Cas. "The Populist Zeitgeist." *Government and Opposition* 39, no. 4 (2004): 541–63. <https://doi.org/10.1111/j.1477-7053.2004.00135.x>
- Muller, Jan Warner. Essay. In *What Is Populism?*, translated by Enela Topulli, 96. Prishtinë, Kosovë: Botimet Poema, 2019
- Pankowski, Rafal. "Taggart, Paul (2000), Populism. Buckingham: Open University Press" *Comparative Sociology* 2, no. 3 (2003): 566–68. <https://doi.org/10.1163/15691330-00203013>
- Rodi, Patricia, Lazaros Karavasilis, and Leonardo Puleo. "When Nationalism Meets Populism: Examining Right-Wing Populist & Nationalist Discourses in the 2014 & 2019 European Parliamentary Elections." *European Politics and Society*, 2021, 1–19. <https://doi.org/10.1080/23745118.2021.1994809>
- Saliu, Hasan. Rethinking Media Diplomacy and Public Diplomacy Towards a New Concept: Digital Media Diplomacy. *Online Journal Modelling the New Europe*, (2022), 39, 1-24. DOI: [10.24193/OJMNE.2022.39.01](https://doi.org/10.24193/OJMNE.2022.39.01)

Saliu, Hasan. Public Diplomacy or Public Glocalization? Rethinking Public Diplomacy in the post-Truth Era. *Vestnik Moskovskogo universiteta. Seriya 10. Zhurnalistika*, 1, 2022. 157-175. [DOI: 10.30547/vestnik.journ.1.2022.157175](https://doi.org/10.30547/vestnik.journ.1.2022.157175)

Saliu H. & Lljunji V. (2022). Cultural Diplomacy of Kosovo after the Declaration of Independence. *Information & Media*, 93, 62-76. <https://doi.org/10.15388/Im.2022.93.61>

Saliu, Hasan. The specifics and complexity of EU public diplomacy. *Druzboslovne Razprave*, XXXVII(96–97), 189–207. 2021. <https://www.sociolosko-drustvo.si/wp-content/uploads/2021/09/DR96-97-Saliu-WEB.pdf>

Saliu, Hasan. Public Diplomacy and Related Concepts from the Perspective of Lasswell's Communication Formula. *Jahr – European Journal of Bioethics*, 11(2), 2020. 357-376. <https://doi.org/10.21860/j.11.2.2>

Saliu, Hasan. The Evolution of the Concept of Public Diplomacy from the Perspective of Communication Stakeholders. *Medijska istraživanja*, 26 (1), 69-86. 2020. <https://doi.org/10.22572/mi.26.1.4>

Saliu, Hasan. Multiple Target Audiences, Critical Analysis of Pristina-Belgrade Dialogue. *On-line Journal Modelling the New Europe*, 26, 108-123. 2018. Doi:[10.24193/OJMNE.2018.26.08](https://doi.org/10.24193/OJMNE.2018.26.08)

Saliu, Hasan. *Komunikimi në diplomacinë publike: Soft power-i dhe imazhi ndërkombëtar i Kosovës*. Prishtinë: Kolegji AAB. 2015.

Jakob Schwörer and Xavier Romero-Vidal, “Radical Right Populism and Religion: Mapping Parties’ Religious Communication in Western Europe,” *Religion, State and Society* 48, no. 1 (January 2020): pp. 4-21, <https://doi.org/10.1080/09637494.2019.1704611>

TENENBOIM-WEINBLATT, NAAMA WEISS. “Israel: Right-Wing Populism and Beyond.” *Populist Political Communication in Europe*, n.d., 217–30. <https://doi.org/10.4324/9781315623016-25>

Von Beyme, Klaus. “Party Leadership and Change in Party Systems: Towards a Postmodern Party State?” *Government and Opposition* 31, no. 2 (1996): 135–59. <https://doi.org/10.1111/j.1477-7053.1996.tb00601.x>

Wilhoit, Francis M. "Populism. by Margaret Canovan. (New York: Harcourt Brace Jovanovich, 1981)." *American Political Science Review* 76, no. 1 (1982): 160–61.  
<https://doi.org/10.2307/1960490>

Zembylas, Michalinos. "Affect and the Rise of Right-Wing Populism," 2021.  
<https://doi.org/10.1017/9781108974578>

### **Video nga interneti**

*Albin Kurti. YouTube.* Kohavision , 2021. <https://www.youtube.com/watch?v=l73FvrKnYNs>.

*Albin Kurti. YouTube.* Kohavision, 2021. <https://www.youtube.com/watch?v=8t4e6icBQeE>.

*Albin Kurti. YouTube.* RTV21, 2019. <https://www.youtube.com/watch?v=slvzSjNGuBw>.

*Albin Kurti .YouTube.* RTK, 2021. <https://www.youtube.com/watch?v=sEEs2i2OaYY>.

*Albin Kurti .YouTube.* RTV21, 2021. <https://www.youtube.com/watch?v=eX95YmACaKA>.

*Albin Kurti. YouTube.* Kohavision, 2021. [https://www.youtube.com/watch?v=ufVV007g6\\_c](https://www.youtube.com/watch?v=ufVV007g6_c).

*Albin Kurti. YouTube.* Kohavision, 2021. <https://www.youtube.com/watch?v=Eqym57ak5rA>.

*Albin Kurti. YouTube.* Klan Kosova, 2021. <https://www.youtube.com/watch?v=7vC1uSof4do>.

*Albin Kurti. YouTube.* Klan Kosova, 2021. <https://www.youtube.com/watch?v=7vC1uSof4do>.

*Albin Kurti. YouTube.* Kohavision, 2019. <https://youtu.be/pv33f412cRs>.

*Albin Kurti. YouTube.* RTK, 2019. <https://www.youtube.com/watch?v=CzI0btvDwOE>.

*Albin Kurti . YouTube.* RTK, 2019. <https://www.youtube.com/watch?v=uJrssTv750k>.

*Albin Kurti. YouTube.* RTV21, 2019. <https://www.youtube.com/watch?v=jcPdEBIJmRo>.

*Albin Kurti. YouTube.* RTV21, 2019. <https://www.youtube.com/watch?v=pUxXnkCsOjk>.

*Albin Kurti. YouTube.* Kohavision, 2019. <https://www.youtube.com/watch?v=iTuf5eU9swE>.

*Albin Kurti. YouTube.* Kohavision, 2021. <https://www.youtube.com/watch?v=-1jrn-tcdkg>.

*Albin Kurti. YouTube.* RTV21, 2019. [https://www.youtube.com/watch?v=\\_f3bSSyvhdM](https://www.youtube.com/watch?v=_f3bSSyvhdM).

*Albin Kurti . YouTube.* RTV21, 2019. [https://www.youtube.com/watch?v=YkkF0k\\_jiME](https://www.youtube.com/watch?v=YkkF0k_jiME).

*Albin Kurti . YouTube.* Klan Kosova, 2021. <https://www.youtube.com/watch?v=NbzaStckess>.

*Albin Kurti. YouTube.* RTK, 2021. <https://www.youtube.com/watch?v=sEEs2i2OaYY>.

*Albin Kurti . YouTube.* Kohavision, 2021. <https://www.youtube.com/watch?v=Oprmgz-wUGY>.

*Albin Kurti. YouTube.* Kohavision, 2021. <https://www.youtube.com/watch?v=puq5rZmLPro>.

*Albin Kurti. YouTube.* Kohavision, 2021. <https://www.youtube.com/watch?v=qDcHhwBS5p0>.

*Albin Kurti . YouTube.* Kohavision , 2021. <https://www.youtube.com/watch?v=CITVGEwj8>.

*Albin Kurti. YouTube.* RTK, 2021. <https://www.youtube.com/watch?v=KD2Oedsf2cc>.

*Albin Kurti. YouTube.* RTV21, 2021. [https://www.youtube.com/watch?v=k\\_Y1cYLLhI4](https://www.youtube.com/watch?v=k_Y1cYLLhI4).

*Albin Kurti . YouTube.* Kohavision, 2021. [https://www.youtube.com/watch?v=mi\\_JYs-BKNs](https://www.youtube.com/watch?v=mi_JYs-BKNs).

*Albin Kurti . YouTube.* RTV21, 2021. <https://www.youtube.com/watch?v=1wKaKFU6nNs>.

*Albin Kurti. YouTube.* RTK, 2021. [https://www.youtube.com/watch?v=ac3AI\\_bpsYM&t=1322s](https://www.youtube.com/watch?v=ac3AI_bpsYM&t=1322s).

*Albin Kurti. YouTube.* Kohavision, 2021. [https://www.youtube.com/watch?v=tavDPKK\\_bRI](https://www.youtube.com/watch?v=tavDPKK_bRI).

*Albin Kurti. YouTube.* RTK, 2021. <https://www.youtube.com/watch?v=AGT0aF7kVJU&t=909s>.

*Albin Kurti . Cosmo: Si e Njoh Albin Kurti?* Kohavision, 2020.  
<https://www.youtube.com/watch?v=1KH3yZFNNKg>.

*Bujar Dugolli. Cosmo: Si e Njoh Albin Kurti?* Kohavision, 2020.  
<https://www.youtube.com/watch?v=1KH3yZFNNKg>.

## **Webliografia**

Ahmeti, Adelina. “Gjykata Supreme Lë Jashtë Listës Albin Kurtin.” Raporto Korrupsionin! KALLXO.com, January 29, 2021. <https://kallxo.com/lajm/gjykata-supreme-le-jashte-listes-albin-kurtin/>.

“Biografia E Kryeministrit.” Zyra e Kryeministrit. Qeveria e Kosoves, April 7, 2022. <https://kryeministri.rks-gov.net/home/biografia-e-kryeministrit/>.

Gazeta Telegraf. “Kuvendi I Kosovës Voton pro Mocionit Kundër Qeverisë Së Albin Kurtit.” Gazeta Telegraf, March 25, 2020. <https://telegraf.al/politike/kuvendi-i-kosoves-voton-pro-mocionit-kunder-qeverise-se-albin-kurtit/>.

Krasniqi, Egzona. “KQZ Miraton Formularët e Zgjedhjeve, Pa Albin Kurtin.” Gazeta Online Reporteri.net, February 6, 2021. <https://reporteri.net/lajme/pa-kategori/kqz-miraton-formularet-e-zgjedhjeve-pa-albin-kurtin/>.

“Kush Është Albin Kurti, Kryeministri I Kosovës.” Gazeta Express, February 3, 2020. <https://www.gazetaexpress.com/kush-eshte-albin-kurti-kryeministri-i-kosoves/>.

“Reagimet Pas Zhvillimeve Të Djeshme Në Kuvend, Raport i KTV-Së [Video].” Koha.net. Koha.net. Accessed October 1, 2022. <https://archive.koha.net/?l=81125>.

RTV21, V Grabanica, and Esad R. Dujaka. “Vetëvendosje Zyrtarisht Regjistrohet Si Parti.” RTV21, May 12, 2017. <https://rtv21.tv/vetevendosje-zyrtarisht-regjistrohet-si-parti/>.

Voa. “Albin Kurti – Kryeministër I Kosovës.” VOA. Zëri i Amerikës, February 4, 2020. <https://www.zeriamerikes.com/a/kosovo-politics/5271247.html>.